



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. ____ prot.

Tiranë, më 20.4.2022

Lënda: Bisedimet përfundimtare të Komisionerit Publik në çështjen ankim kundër vendimit nr. 363, datë 1.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Elizabeta Imeraj

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së të datës 21.6.2021, aktit Shtesë (*Addendum*) të Rekomandimit, të datës 29.6.2021, duke iu qëndruar parashtrimeve me shkrim të depozituara dhe qëndrimeve të Komisionerit Publik, të mbajtura në seancat gjyqësore të datave 30.3.2022, 31.3.2022, 1.4.2022 dhe 12.4.2022, si dhe provave të administruara gjatë hetimit të zhvilluar në Kolegj në kuadër të këtij gjykimi, Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit të vendimit nr. 363, datë 1.4.2021, për secilin prej tyre, kundrejt prapësimeve të paraqitura, vlerëson se:

Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ankimi i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 363, datë 1.4.2021, është paraqitur jashtë afatit të parashikuar nga neni 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik ripërsërit qëndrimin e mbajtur gjatë zhvillimit të debatit gjyqësor në Kolegj, duke vlerësuar se ky pretendim nuk qëndron dhe nuk gjen mbështetje në ligj dhe në provat e administruara në fashikullin përkatës, të cilat vërtetojnë dorëzimin e ankimit brenda afatit të përcaktuar në ligj.

Ky qëndrim i Komisionerit Publik mbështetet edhe në jurisprudencën¹ e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në interpretimin e dispozitave ligjore në lidhje me llogaritjen e afatit të ankimit ndaj vendimeve të Komisionit.

I. Për shkakun ankimor për vlerësimin e kriterit të pasurisë

1. Lidhur me “deklarimin nga subjekti i rivlerësimit të regjimit pasuror për shkak të martesës”, referuar akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, mbetet e provuar se në Deklaratën “Vetting” dhe në të gjitha Deklaratat Periodike vjetore 2004-2016, të hartuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, nuk është deklaruar ndonjëherë një

¹ Referohuni vendimeve të Kolegjit (JR) nr. 32/2019, nr. 13/2021, nr. 27/2021, nr. 37/2021.

regjim i posaçëm pasuror për shkak të martesës, referuar detyrimin që rrjedh nga marrëdhëniet pronësore, që rregullon një regjim i tillë, të cilat pasqyrohen në krijimin e pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme objekt deklarimi, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar dhe ligjit nr. 84/2016.

1.1 Sikundër trajtuar në ankim dhe në parashtrimet e seancës së datës 30.3.2022, bazuar në tituj për fitimin e pronësisë të njohur nga ligji (kontrata), subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në Deklaratën “Vetting” dhe deklaratat periodike vjetore, pasuri të paluajtshme në bashkëpronësi, në mungesë të pasqyrimin të rrethanës se është në kushtet e një regjimi pasuror të pasurive të ndara, i cili do të kishte efektet përkatëse në pasuritë e deklaruara.

1.2 Hetimi administrativ për subjektin e rivlerësimit, në kuadër të rivlerësimit kalimtar, ka filluar në datën 31.10.2018, dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar apo pretenduar ekzistencën e regjimit të pasurive të ndara deri në datën 17.9.2020, datë në të cilën është pyetur nga Komisioni mbi ekzistencën e regjimit pasuror për shkak të martesës.

1.3 Në këto rrethana, pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi ekzistencën e regjimit të posaçëm pasuror për shkak të martesës, vijnë në kontradiktë me deklarimet ndër vite, veprimet juridike dhe sjelljen e saj në cilësinë e bashkëpronares, si dhe deklarimet e saj në Deklaratën “Vetting”.

2. Lidhur me “Pasurinë truall me sip. 2.500 m²”, ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 21.6.2021, në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 12.2.2020³, akt ky që në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arrin të provojë të kundërtën lidhur me sa vijon:

2.1 Pretendimin lidhur me rrethanat mbi të cilat janë krijuar pasuritë e paluajtshme, si në regjimin e pasurive të ndara, ashtu edhe në bashkëpronësinë faktike të personit të lidhur me familjarët e tij, pretendim që nuk gjen mbështetje në aktet e administruara në dosje, referuar legjislacionit në fuqi⁴.

2.2 Për sa i përket fitimit të titullit të pronësisë së personit të lidhur dhe vetë subjektit të rivlerësimit, rezulton se gjatë hetimit administrativ janë administruar kontrata noteriale⁵, që provojnë titullin e pronësisë.

2.3 Aktet noteriale të mësipërme si tituj pronësie dhe deklarimi i tyre në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, dorëzuar pranë ILDKPKI-së, përbëjnë provë në kuptim të legjislacionit përkatës në fuqi dhe nenit 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016.

2.4 Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë truall 2.500 m², në Deklaratën “Vetting” dhe në DV-2012, deklarohet shkëmbimi i pasurive të ndodhura në ***, Tiranë⁶, ndërsa gjatë hetimit administrativ të procesit të rivlerësimit, subjekti ka pretenduar rishtazi se: [...] *si kompensim*

² Pasuria e paluajtshme me nr. ***, ZK ***, me sipërfaqe 2.500 m², e ndodhur në rrugën “***”, Tiranë.

³ Referohuni germës d), f. 6-8 e Rekomandimit, si dhe faqes 6 të Gjetjes së ONM-së nr. 208 prot., datë 12.2.2020.

⁴ Pronësia fitohet nëpërmjet mënyrave të caktuara në këtë Kod dhe mënyrave të tjera të caktuara me ligj të veçantë – neni 163 i K. Civil.

⁵ Kontratë shkëmbimi (pasuri të paluajtshme) nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **11.2012; Kontratë nr. *** rep. *** kol., datë **10.2006; Kontratë nr. *** rep. nr. *** kol., datë **2.2007; Kontratë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **6.2007.

⁶ Referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr.139, datë 13.2.2008, “Për miratimin e çmimeve të trojeve ...”, vlera e pasurisë truall 2500 m² tek *** rezulton 71.647.500 lekë, ndërsa vlera e pasurisë 1464 m² tokë arë në *** rezulton 341.122 lekë, ndërsa si tokë truall në *** rezulton 2.534.134 lekë.

për shkëmbimin e pasurive të paluajtshme ka shërbyer dhe shuma prej 80.000 euro nga shërbimet e avokatisë të ofruara nga personi i lidhur [...] ⁷.

2.5 Për shumën e pretenduar 80.000 euro, mbeten të paprovuara me dokumentacion mbështetës shërbimet e kryera, si dhe plotësimi i kritereve të parashikuara nga neni D i aneksit të Kushtetutës, me qëllim konsiderimin e tyre si të ligjshme, në formën e burimit dhe të të ardhurave.

2.6 Për sa i përket burimit tjetër të pasurive, *tokë arë*, ndodhur në ***, Tiranë, ku përfshihet edhe pasuria nr.*** (numri kadastral) me sip. 400 m², mbetet e paprovuar mbulimi me burime të ligjshme, nga të ardhura të ligjshme të blerjes së kësaj pasurie në datën **.6.2007.

2.7 Edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, mbi pagesën e çmimit prej 1.000.000 lekë, për pasurinë me nr.***, në datën **.10.2006, nuk u provua mundësia financiare e personit të lidhur, për mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të krijuara deri në prill 2007, përfshi këtu edhe pagesën e pasurisë *tokë arë 400 m²*, siç gjen trajtim në elementet e pasurisë *godinë banimi 5 kate, në rrugën “**** **”, Tiranë*.

2.8 Në përfundim për pasurinë *“Truall me sip. 2.500 m²”* dhe pasuritë *“Tokë arë”⁸*, në **, Tiranë, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3, të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

3. *Lidhur me “Pasurinë apartament me sip. 66 m²⁹dhe Shtesa e legalizuar 70,4 m²¹⁰, ndodhur në rrugën “**** **”, Tiranë, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 21.6.2021, në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 12.2.2020¹¹ dhe Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 4.2.2022¹², akte këto që në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me:*

3.1. *Mospërputhjet e deklarimeve për pjesët takuese në bashkëpronësisë në këtë pasuri, pasi në Deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar bashkëpronësi, ndërsa në DV-2008 ka deklaruar bashkëpronësi dhe pjesë takuese në masën 25%.*

3.2. *Mospërputhjet lidhur me vlerën e pasurisë, pasi në Deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën e apartamentit me sip. 66 m² në shumën 4.000.000 lekë, ndërsa në DV-2008 ka deklaruar vlerën në shumën 45.000 euro, përkundër sa provohet se transfertat e kryer në favor të shitëses ***.***, për blerje apartamenti, është në shumën 90.000 euro.*

3.3. *Mospërputhjet lidhur me burimin e krijimit të pasurisë, pasi në Deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim kredinë në ***, ndërsa në DV-2008 ka deklaruar se çmimi është paguar bashkërisht me vëllain e personit të lidhur.*

3.4. Subjekti i rivlerësimit, gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me mundësinë financiare për të mbuluar me burime të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, të pagesës së legalizimit në vitin 2015, si dhe shlyerjen e kësteve të kredisë, pasi nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave nga qiraja, sikundër trajtuar në ankim dhe në parashtrimet e datës 30.3.2022.

⁷ Përgjigjet e subjektit të rivlerësimit të datës **.5.2019, rubrika F, pika 4.

⁸ Tokë arë me sip. 532 m² (pasuria me nr.***), arë me sip. 532 m² (pasuria me nr.***), arë më sip. 400 m² (pasuria ***)

⁹ Pasuria e paluajtshme me nr.***, ndodhur në ZK ***.

¹⁰ Pasuria e paluajtshme me nr.***, ndodhur në ZK ***.

¹¹ Referohuni gërmës b), f. 4-5 e Rekomandimit, si dhe faqes 4-5 të Gjetjes me nr. 208 prot., datë 12.2.2020.

¹² Referohuni f. 9 të Gjetjes nr. 408/11 prot.

3.5. Marrëdhëniet e huave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, konkretisht: (i) hua marrë nga z. ****.*** (vëllai i personit të lidhur), në shumën 45.000 euro, dhe (ii) hua marrë nga personi i lidhur, në shumën 55.000 euro, nuk rezultojnë të deklaruara më parë në deklaratat periodike vjetore dhe Deklaratën “Vetting”, në përmbushje të detyrimeve, që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003, i ndryshuar¹³. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit janë kontradiktore, pasi në DV-2008 si destinacion i kredisë 100.000 euro është deklaruar blerja e apartamentit në rrugën “****.***” dhe rrugën “**** ****”, ndërsa gjatë hetimit deklarohet se nga kredia 100.000 euro, shuma prej 45.000 euro ka shërbyer për shlyerjen e huas së marrë nga vëllai i personit të lidhur, shtetasi ****.***.

3.5.1. Referuar sa më lart, në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, e datës 4.2.2022, parashtrohet se: [...] *Lidhjet financiare dhe personale të subjektit të rivlerësimit, znj. Imeraj, ish-bashkëshortit të saj dhe ish-kunatit të saj përputhen me faktin në vijim: më datë *.1.2008, ****.*** (personi i lidhur), hyri në një marrëdhënie huaje me bankën ****, në shumën 100.000 euro, ku garantore për kredinë ishte E. Imeraj. Më tej, një pjesë e konsiderueshme e kësaj huaje, në shumën e të paktën 45.000 euro, sipas subjektit E. Imeraj dhe një deklaratë noteriale të shtetases ****.***, u shpenzua për pagesën e detyrimit debitor të ****.***. (vëllai i personit të lidhur), kundrejt shtetases ****.***[...].*

3.6. Në përfundim, për pasurinë Apartament me sip. 66 m² dhe Shtesë e legalizuar me sip. 70,4 m², vlerësohet se deklaratimet e ndryshme të subjektit të rivlerësimit, gjatë plotësimit të Deklaratës “Vetting”, Deklarimeve Periodike Vjetore, deklaratimeve gjatë procesit të rivlerësimit dhe qëndrimit gjatë hetimit administrativ, në drejtim të shpjegimeve të dhëna dhe dokumentacionit të përcjellë në lidhje me këto pasuri të paluajtshme, krijojnë pamundësinë për të verifikuar se cilat ndër deklaratimet e subjektit të rivlerësimit pasqyrojnë situatën e vërtetë faktike lidhur me krijimin e pasurive në fjalë dhe, për rrjedhojë, çojnë në pamundësi objektive për të kontrolluar ligjshmërinë e burimeve të krijimit të tyre¹⁴.

3.7. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit konstatohet se është i pamjaftueshëm, në referencë të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

4. *Lidhur me “Pasurinë apartament me sip.73 m²”¹⁵, ndodhur në rrugën “**** ****”, Tiranë, blerë më datë *.1.2008, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 21.6.2021, në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 12.2.2020¹⁶, akt ky që, në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me:*

4.1. *Pamjaftueshmërinë financiare të konstatuar për blerjen e kësaj pasurie në datën *.1.2008, me vlerën e pasqyruar në kontratë, për sa kohë që nga përmbajtja e deklaratës periodike vjetore nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur me të, të kenë deklaruar kursime në cash në deklaratimet paraardhëse, ndërsa kredia bankare pranë ****-së, e deklaruar në DV-2008, nga subjekti si burim krijimi për këtë pasuri, rezulton e marrë pas blerjes së pasurisë.*

4.2. Pamjaftueshmëria financiare si më sipër i referohet çmimit të blerjes të përcaktuar në kontratë, në shumën prej 500.000 lekë, çmim ky ndjeshëm më i ulët se vetë çmimi i blerjes së

¹³ Nuk deklarohet huamarrja dhe kthimi huas në shumën 55.000 euro, si dhe destinacioni i kredisë, i pretenduar të ketë shërbyer pjesërisht për shlyerjen e huas në shumën 45.000 euro.

¹⁴ Qëndrim ky i mbajtur edhe në jurisprudencën e Kolegjit, vendimi (JR) nr.11/2020.

¹⁵ Pasuria e paluajtshme me nr. ****, ZK ****, apartament me sip.73 m² ndodhur në rrugën “**** ****”, Tiranë.

¹⁶ Referohuni gërmës b), f. 5 e Rekomandimit, si dhe faqes 5-6 të Gjetjes me nr. 208 prot., datë 12.2.2020.

kësaj pasurie 12 vite më parë, në shumën 1.750.000 lekë, apo vlerësimin të kryer referuar raportit të vlerësimit në dosjen e bankës ***, në shumën prej 146.000 euro.

4.3. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit konstatohet se është i pamjaftueshëm, në referencë të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

5. *Lidhur me “Kredinë në emër të subjektit të rivlerësimit pranë ***, marrë në vitin 2006”*, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 21.6.2021, në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 12.2.2020¹⁷, akt ky që, në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me:

5.1. *Pamjaftueshmërinë financiare* të konstatuar për shlyerjen e kredisë në maj 2007, për sa kohë që nuk rezultoi të ketë deklaruar kursime *cash* apo posedim të likuiditeteve *cash* në DV-2006, referuar dhe jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit në lidhje me deklarimin e kursimeve *cash* nga ana e subjekteve të rivlerësimit¹⁸.

5.1.1. Ky burim i pretenduar nuk konstatohet i deklaruar nga subjekti as në DV-2007, ku deklarohet: *shlyerje totale kredie nga personi i lidhur*, akt i cili, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, konsiderohet si provë në këtë proces.

5.2. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit konstatohet se është i pamjaftueshëm, në referencë të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

6. *Lidhur me pasurinë “Godinë banimi 5-kate”, ndodhur në rrugën “*** **”, Tiranë*, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, datë 21.6.2021, në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 12.2.2020¹⁹ dhe në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 4.2.2022²⁰, akte këto që, në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, nuk arriti të provojë të kundërtën lidhur me:

6.1. *Titullin e pronësisë mbi këtë pasuri*, pasi pretendimi i subjektit të rivlerësimit, lidhur me rrethanat mbi të cilat është krijuar kjo pasuri e paluajtshme, në bashkëpronësi faktike të personit të lidhur me familjarët e tij, nisur nga përmbajtja e akteve të administruara në dosjen e Komisionit, nuk gjen referencë ligjore, në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e bashkëpronësisë.

6.1.1. Nisur nga përmbajtja e dokumentacionit ligjor të administruar gjatë hetimit administrativ: (i) kontratë shitje pasurie e paluajtshme e datës **.4.2006, për pasurinë *truall* me sip 332 m², si dhe (ii) leje legalizimi nr. ***, datë **.3.2011, rezultoi se pasuria *truall*, dhe ndërtimi i ngritur mbi këtë truall, deri në momentin e plotësimit të Deklaratës “Vetting”, kanë pasur mbajtës të titullit të pronësisë, personin e lidhur.

6.1.2. Nga aktet e administruara në fashikull rezultoi se pasuria “truall” me sip. 332 m² e ndodhur në ***, Tiranë, ka shërbyer si garanci pasurore për marrjen e një kredie nga subjekti i rivlerësimit, në shumën 2.000.000 lekë, në datën **.10.2006 (*para lidhjes së martesës*), ku personi i lidhur ka dalë dorëzanës dhe hipotekues me pasuritë e poseduara/në pronësi prej tij.

¹⁷ Referohuni gërmës a), f. 2-4 të Rekomandimit, si dhe faqes 4 të Gjetjes me nr. 208 prot., datë 12.2.2020.

¹⁸ Vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18, të prg. 27; (JR) nr. 19/2019, në prg. 84; (JR) nr. 20/2019, në prg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019, në prg. 31.

¹⁹ Referohuni gërmës a), f. 6 e Rekomandimit, si dhe faqes 5 të Gjetjes me nr. 208 prot., datë 12.2.2020.

²⁰ Referohuni gjetjes nr. 408/11 prot., datë 4.2.2022, f. 9.

6.2. *Burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë Godinë banimi 5-katëshe*, pasi edhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet e subjektit të rivlerësimit mbi mundësinë e financimit të personit të lidhur, vetëm për katin e tretë të banesës 5-katëshe, nuk u provuan burimet e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie.

6.2.1. Referuar pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, për të përfshirë në analizën financiare, shumën 5.313.509²¹ lekë, të dërguar nga z. ***.*** (vëllai i personit të lidhur), në llogarinë e personit të lidhur, aftësia financiare duhet të mbajë në konsideratë, gjithashtu, si shpenzim edhe investimin e vetë z. ***.*** (vëllai i personit të lidhur), për dy katet e tjera të banimit në të njëjtën godinë, që aktualisht rezultojnë në pronësi të tij. Sa më lart do të rezultonte në pamjaftueshmëri të burimeve financiare, pasi vlera e investimit është më e lartë se vlera e dërgesave.

6.2.2. Referuar pretendimit tjetër të subjektit të rivlerësimit, për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat nga qiraja e ambientit të ndodhur në rrugën “**** ****”, për vitet 2005-prill 2007, rezulton se pasuria e dhënë me qira, gjatë këtyre viteve ka qenë në pronësi të vëllait të personit të lidhur (z. ***.***) dhe deklarimi i këtyre të ardhurave pranë organeve tatimore nga personi i lidhur është kryer pas dorëzimit të Deklaratës “Vetting”. Referuar përgjigjes së organeve tatimore, shkresave të Drejtorisë Rajonale Tatimore, nr. *** prot., datë **.2.2021; nr. *** prot., datë **.2.2021, dhe shkresës nr. *** prot., datë **.11.2019, të depozituara nga vetë subjekti gjatë hetimit administrativ, konfirmohet se këto të ardhura janë përfshirë nga personi i lidhur në të ardhurat individuale të vetëdeklaruara të vitit 2011 dhe ky i fundit është regjistruar si individ për deklaratën e DIVA-s, me datë regjistrimi në sistemin @ Cats **.1.2018 dhe me datë fillimi transaksioni **.1.2011.

6.2.3. Në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, të datës 4.2.2022²², për përmbajtjen e së cilës subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prapësimet e saj²³, paraqiten këto rrethana të lidhura me kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...] *Fakti që **.*.*, ish-kunati i subjektit Elizabeta Imeraj, është dënuar në Itali, është i rëndësishëm jo vetëm për komponentin e vlerësimit të figurës së Elizabeta Imeraj, e shpjeguar në detaje në Gjetjen me nr. prot. 850, datë 21.10.2020, por është i rëndësishëm edhe në funksion të vlerësimit të pasurisë. Konkretisht, siç ka deklaruar edhe vetë Elizabeta Imeraj, banesa në të cilën ajo ka jetuar prej vitit 2007 dhe deri më sot, është ndërtuar edhe me fondet e **.*.*(ish-kunati)...meqenëse **.*.*(ish-kunati) është një person i dënuar në vitin 2002, për veprat penale të fushës së krimit të organizuar, është logjike të konkludohet se **.*.*(ish-kunati) ka realizuar të ardhura të paligjshme, si anëtar i një grupi të strukturuar kriminal dhe se këto të ardhura të fituara në mënyrë të paligjshme ai i ka investuar në ndërtimin e shtëpisë në të cilën jeton edhe sot Elizabeta Imeraj. Ky konkluzion është edhe më bindës, po të kemi parasysh faktin se KPK-ja e ka pranuar të besueshëm shpjegimin se edhe **.*.*(ish-kunati) ka investuar në ndërtimin e banesës familjare të sipërpërmendur [...].*

6.3. Në këto kushte, deklarimi i subjektit të rivlerësimit konstatohet se është i pamjaftueshëm, në referencë të parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

²¹ Megjithëse nga aktet e administruara për të provuar të ardhurat e ligjshme të z. ***.***, për periudhën 2004-2006, rezulton se të ardhurat nuk janë të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e jetesës në Angli dhe shumat e dërguara **.*.*.*.

²² Referohuni Gjetjes së vëzhguesit ndërkombëtar, faqe 9 e saj.

²³ Referohuni pikës 15.2., faqe 81 e Parashtrimeve paraqitur nga subjekti i rivlerësimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit.

II. Për shkakun ankimor për vlerësimin e kriterit të figurës

7. Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, në zbatim të Rekomandimit të ONM-së, të datës 21.6.2021, aktit Shtesë (*Addendum*) të Rekomandimit, të datës 29.6.2021, duke iu qëndruar parashtrimeve me shkrim të depozituara dhe qëndrimeve të Komisionerit Publik të mbajtura në seancat gjyqësore të datave 30.3.2022, 31.3.2022, 1.4.2022 dhe 12.4.2022, vlerëson se Gjetjet e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, të datës 8.10.2020²⁴, datës 21.10.2020²⁵, të administruara nga Komisioni dhe Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 4.2.2022,²⁶ administruar nga Kolegji, në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbëjnë provë që dëshmon një fakt, rrethanë apo standard ligjor.

7.1. Respektivisht, për secilën prej *Gjetjeve*, në rend kronologjik, citojmë:

7.2. Në Gjetjen e datës 8.10.2020 dhe datë 21.10.2020, parashtrohen fakte dhe rrethana, të cilat janë trajtuar rishtazi në Gjetjen e datës 4.2.2022, të administruar nga ana e Kolegjit.

7.3. Në Gjetjen e datës 4.2.2022, në vijim të dy Gjetjeve të sipërpërmendura dhe prapësimeve së subjektit të rivlerësimit, se personat me emrat ****.**** dhe ****.****, të cituar në vendimin gjyqësor, duket se nuk ishin ish-bashkëshorti i saj dhe ish-kunati i saj, për shkak të identitetit të ndryshëm të tyre dhe pretendimit se, në asnjë rrethanë, subjekti i rivlerësimit nuk mund të dinte përfshirjen në ndonjë aktivitet kriminal të tyre për të cilën mund të akuzoheshin penalisht, qoftë në Shqipëri apo gjetkë, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së parashtron se, mbi bazën e materialit provues/dokumentacionit shkresor, që i bashkëlidhet Gjetjes, arrihet në këto përfundime: [...] (i) ****.***, ish-bashkëshorti i Elisabeta Imerajt, dhe ***.***, ish-kunati i saj, janë, në të vërtetë, persona të cilët, nën identitete false të ***.*** (lindur më ***1.1970*, në Jugosllavi) dhe ****.*** (lindur në ***10.1975*, në Kosovë), janë dënuar më vendimin e shkallës së parë të Gjykatës së Rrethit, Kolegji Penal, Romë, për veprën penale të emigracionit të paligjshëm, veprën penale vazhduese të shfrytëzimit të prostitucionit, kryer në bashkëpunim, dhe veprën penale vazhduese të rrëmbimit, të kryer gjithashtu në bashkëpunim. ****.*** (ish-bashkëshorti) është dënuar me 8 vjet burgim dhe gjobë prej 55.000 euro, ndërsa ****.*** (ish-kunati) me 7 vjet burgim dhe gjobë prej 54.000 euro. Në apel, me vendim të Gjykatës së Apelit të Romës, ****.*** (ish-bashkëshorti) është shpallur i pafajshëm, ****.*** (ish-kunati) është dënuar përfundimisht me 7 vjet burgim dhe gjobë 54.000 euro (vini re në vijim, dënimi është reduktuar në 4 vjet burgim dhe 10.000 euro gjobë, në bazë të të ashtuquajturit instituti “indulto”, një masë faljeje që mund të ulë dënimin, por nuk shuan përgjegjësinë penale); (ii) Elisabeta Imeraj mund dhe duhej t'i kishte vërtetuar lehtësisht këto fakte dhe t'i kishte deklaruar ato në përputhje me nenin 35, pika 1 e ligjit 84/2016; (iii) Të gjitha faktet e sipërpërmendura duhen të konsiderohen dhe të vlerësohen jo vetëm për sa i përket vlerësimit të figurës së Elisabeta Imeraj, por, gjithashtu, në kuadër të vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimit të përgjithshëm [...].******

8. Për sa më sipër, faktet që dalin nga vendimi penal i Gjykatës së Romës (Itali), datë ***12.2002*, janë relevante, sikurse parashtrohet në Rekomandim e ONM-së të datës 21.6.2021, aktin *Addendum*, të datës 29.6.2021, si dhe Gjetjeve të vëzhguesit ndërkombëtar, të datës 8.10.2020²⁷, datës 21.10.2020²⁸ dhe datës 4.2.2022,²⁹ dhe duhet të konsiderohen për këtë kriter rivlerësimi në kuadër të zbatimit të nenit DH, të aneksit të Kushtetutës.

²⁴ Referohuni Gjetjes nr.796 prot. datë 8.10.2020.

²⁵ Referohuni Gjetjes nr. 850 prot. datë 21.10.2020.

²⁶ Referohuni Gjetjes nr. 408/11 prot., datë 4.2.2022.

²⁷ Referohuni nëndarjes II., f. 8-9 të Rekomandimit, si dhe faqes 2 të Gjetjes nr.796 prot., datë 8.10.2020.

²⁸ Referohuni Gjetjes nr. 850 prot., datë 21.10.2020.

²⁹ Referohuni Gjetjes nr. 408/11 prot., datë 4.2.2022, f. 9-11.

III. Për shkakun ankimor për vlerësimin e aftësive profesionale

9. Komisioneri Publik, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit, parashtrimin të paraqitur dhe qëndrimeve të mbajtura në seancat gjyqësore të zhvilluara në Kolegj, në kuadër të këtij gjykimi, vlerëson se Gjetja e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, datë 6.8.2020,³⁰ paraqitur Komisionit, në referencë të pikës 10, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, përbën provë lidhur me mangësitë e konstatuara në dy procedimet penale³¹, në të cilat subjekti i rivlerësimit ishte në cilësinë e prokurores të çështjes, përkatësisht në procedimin penal në ngarkim të shtetasit ***.*** dhe atë në ngarkim të shtetasit ***.***.

10. Për sa është parashtruar në Shtesën e Rekomandimit, datë 29.6.2021³², lidhur me përfaqësimin që subjekti i rivlerësimit i ka bërë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në procedimin penal të konkluduar me vendimin penal nr. **, datë **.6.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, referuar shpjegimeve të dhëna nga ana e subjektit të rivlerësimit gjatë gjykimit, duhet vlerësuar nga Kolegji, sipas parashikimeve të pikës 4, të nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

11. Për sa më sipër, rrethanat e dala, sikurse parashtrohet në Rekomandim e ONM-së, të datës 21.6.2021, aktin *Addendum*, të datës 29.6.2021, në Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 6.8.2020, duhet të konsiderohen për këtë kriter rivlerësimi në kuadër të zbatimit të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, dhe ligjit nr. 84/2016.

IV. Për shkakun ankimor për çështje të etikës dhe vlerësimit tërësor

12. Komisioneri Publik, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit, parashtrimin të paraqitur dhe qëndrimeve të mbajtura në seancat gjyqësore të zhvilluara në Kolegj, në kuadër të këtij gjykimi, vlerëson se përmbajtja e tri Gjetjeve, që i përkasin vlerësimit të çështjeve të etikës dhe vlerësimit tërësor, si vijon: (i) Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, të datës 30.9.2020³³, lidhur me ndikimin tek ish-vëzhguesi ndërkombëtar, z. ***.***; (ii) Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 21.10.2020, lidhur me procedurat gjyqësore të divorcit të subjektit të rivlerësimit³⁴; (iii) Gjetjen e vëzhguesit ndërkombëtar të datës 21.12.2020,³⁵ lidhur me dorëheqjen e njëres nga anëtarët e trupës gjyqësore të Komisionit, përbëjnë provë për rrethanën, çështjen konkrete që ato trajtojnë.

12.1. Komisioneri Publik, në kuadër të vlerësimit tërësor të çështjes, referuar parashikimeve të pikës 2, të nenit 4, dhe pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se, për sa është parashtruar në Rekomandimin e ONM-së të datës 21.6.2021, Kolegji duhet të mbajë në konsideratë edhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore në Komision.

V. Kërkimi përfundimtar

13. Duke përfunduar për sa parashtrohet, Komisioneri Publik vlerëson se:

³⁰ Referohuni Gjetjes nr. 646 prot., datë 6.8.2020.

³¹ Procedimi penal në ngarkim të shtetasit ***.*** - Procedimi penal në ngarkim të shtetasit ***.***.

³² Referohuni pikës 1.2 të Shtesës së Rekomandimit, faqe 2.

³³ Referojuni nëndarjes IV., f.10 e Rekomandimit, si dhe faqeve 2-3 të Gjetjes nr.764 prot., datë 30.9.2020.

³⁴ Referohuni Gjetjes nr. 849 prot., datë 21.10.2020.

³⁵ Referohuni Gjetjes nr. 1001 prot., datë 21.12.2020.

14. Në referencë të analizës së provave/akteve të administruara në fashikullin e Komisionit dhe akteve të administruara gjatë hetimit gjyqësor në Kolegj, si dhe parashtrimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit ndodhet në situatën e parashikuar nga neni 61, pika 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

15. Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkohet nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 363, datë 1.4.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA